



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.10.2020 të parashtruar nga OE "Sallahu" Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse", me Nr. të Prok: 616-20-2390-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 20 039 511 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e OE "Sallahu" Shpk të dt. 13.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse", me Nr. të Prok: 616-20-2390-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 20 039 511 – për pjesën e I-re, kundër Njoftimit për tenderues të pasuksesshëm të AK –së, të datës 08.10.2020.
2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për pjesën e I-re, të publikuar me datë: 08/10/2020.

Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për tenderin Ndërtimin e rrugës Stallove –Zllashë, me Nr. të Prok: 616-20-2390-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 20 039 511, sipas Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 08.10.2020.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "Sallahu" Shpk me datë 13.10.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse" **perkatesishte per pjesen e I-re** Ndërtimin e rrugës Stallove –Zllashë, me Nr. të Prok: 616-20-2390-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 20 039 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin se AK me daten 08.10.2020 ka kthyer ne rivleresim edhe loton 4 i cili nuk ka qene objekt rivleresimi dhe se nuk eshte nxjerr vendim nga Autoriteti Kontraktues per rivleresim te ketij loti dhe se nuk jane krijuar kushtet ligjore per rivleresim, Autoriteti Kontraktues ju njofton se: **ky pretendim nuk qendron** pasi qe **Autoriteti Kontraktues** – komisioni per vleresimin e ofertave duke u mbeshtetur ne nenin 59 te LPP (ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve), nenin 27/A te LPP (ndarja e kontratave ne lote), ne Rregullat dhe Udhzuesin Operativ te Prokurimit Publik ka bere vleresimin dhe ka respektuar te gjitha rregullat e parapara ne LPP dhe ne RRUOPP si dhe ka respektuar te gjitha kerkesat e kerkuara ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit. Pra ka respektuar kriterin per dhenje te kontrates çmimin me te lire te pergjegjshem,

Citat: nga RRUOPP- Pika 19. Ndarja e Kontratave ne Lote


Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se 2 Lote atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për lotet që ofrojnë çmimin më të ulët të mundshëm për autoritetin kontraktues dhe Loti tjetër do t'i shpërblehet Operatorit të dytë me radhë.

Pra AK – komisioni për rivlerësimin e ofertave ka vepruar gjithnjë duke e ruajtur kombinimin me te mire te mundshëm, respektivisht kombinimin ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit;

-Lidhur me pretendimin se AK nuk ka përdore formën B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, dhe se ne listën e Operatoreve te përgjegjshëm është edhe OE Kosova Asphalt i cili është i papërgjegjshëm dhe se nuk do te duhej te ishte fare ne liste, Autoriteti Kontraktues ju njofton se: **ky pretendim nuk qendron** pasi qe **Autoriteti Kontraktues** – komisioni per vleresimin e ofertave me daten 08.10.2020 se bashku me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit kontraktues **OE “Bujar Shabani” – Bageri, Integral Shpk, Milenium construction Shpk&Ileea gr Shpk, OE Afrim Beka – Bashkimi Meti & Shkemi**, iu ka derguar letren standarde per tenderues te eliminuar per loton e I-re te projektit, ndrsa ne raportin e vleresimit jane dhene arsyetimet edhe per OE-ik “Kosova Asphalt” per mangesite e tenderit te tij lidhur me lotin 1. Lidhur me pretendimin se i njejt duhet te shpallet i pa pergjegjshem per te gjithë aktivitetin ju sqarojme se kjo eshte e paligjshme, pasi qe secili lot paraqet kontrate te veidhur me pretendimin se i njejt duhet te shpallet i pa pergjegjshem per te gjithë aktivitetin ju sqarojme se kjo eshte e paligjshme, pasi qe secili lot paraqet kontrate te veçante dhe ne dosje jane percaktuar kushtet per secilin lot;

-Lidhur me pretendimin se OE Kema Company, ka ofruar dosjen e ofertimit me pajisje te marrura me qera nga OE Eskavatori dhe i cili eshte ofertues ne kete aktivitet te prokurimit me te njejtat pajisje, poashtu **ky pretendim nuk qendron** pasi qe ne LPP dhe ne RRUOPP nuk eshte e kufizuar askund qe nje OE kur i jap nji OE tjeter pajisjet me qera nuk mund te marr pjese ne ate aktivitet te prokurimit, perkundrzi kur kemi tentuar qe nje kerkese te tille ta perfshjime ne kerkesat e FDT-vena eshte rekomanduar nga KRPP-ja dhe nga Agjencioni Kunder Korupcionit qe kjo kerkese te largohet si kerkese diskriminuese; Po ashtu pretendimi se OE ka dorezuar per automjetin special dokumentin me afat te skaduar dhe jo automjet cisterne edhe ky pretendim nuk qendron se ne kerkesat e kerkuara ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit nuk eshte kerkuar qe librezat e qarkullimit te automjeteve te jene me afat te regjistrimit, andaj edhe automjeti e dorezuar si automjet special me nr. Te regjistrimit 05-492-AK ne baze te verifikimeve nga ana e AK eshte automjet cisterne.

Deshmi foto e cisternes:



- Lidhur me pretendimin se OE Kema Company nuk ka dhene deklarate se posedon 30 punetor te paraqitur ne ATK edhe ky pretendim nuk qendron per arsye se grupi i OE i propozuar

per kontrate ka ofruar vertetimet nga ATK-ja si per OE Kema Company ashtu edhe per anetarin e grupit Pro Co group.

OE Kema Company shpk ne vitin 2017 ne ATK ka te paraqitur 20 punetor, ne vitin 2018-19 punetor, ne vitin 2019-21 punetor, ndersa OE Pro Co group ne vitin 2017 ka te paraqitur ne ATK – 15 punetor, ne vitin 2018-27 punetor dhe ne vitin 2019 – 23 punetor qe te gjitha te vertetuara me vertetimet nga ATK-ja.

- Lidhur me pretendimin se nje anetar i stafit nuk ka pervojen e kerkuar prej dy viteve eshte pjeserisht i qendrueshem, pasi qe ne CV-ne e dorezuar eshte shenuar pervoja prej dates 01.05.2018 deri me 31.08.2018 dhe nuk ka te dhena per pervojen ne periudhen vijuese. Por bazuar ne nenin 72 te LPP-se dhe nenin 39.8 te RRUOPP-se komisioni eshte dashte te kerkoj sqarime shtese, pasi qe pika 39.8.11 thot si vijon: CV-ja e dorezuar nuk prmban informatat e kerkuara, AK nuk mund te vendos, atehere mund te kerkohen informata shtese. Sigurisht se komisioni kete nuk e ka verejte duke u bazuar ne faktin se ka pase me shume se dy vite nga diplomimi, por sido qe te jete edhe sikur te verehej ka pase mundesi ligjore te kerkoj informata shtese.

Po ashtu ju njoftojmë se qellimi i ketij ligji është te siguroj menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, si dhe neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti par. 1 qe thotë se: te gjitha autoritetet kontraktuese, jane te obliguara që të sigurojnë që fondet publike të perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesiste duke marrë ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit.

Bazuar ne kete qellim paresor te LPP-ik edhe perkunder mangesise se paraqitur ne CV, konstatimi im eshte se ajo mangesi nuk paraqet asnje devijim substancial ne raport me diferencen ne mes te çmimeve te tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates dhe pretenduesit qe eshte 57,315.58 euro, ose edhe dallimi me tenderuesin vijues sipas çmimit me diference prej 51,547.55 euro, e cila paraqet devijim substancial ne raportin me qellimin themelor te LPP-se dhe per ate vlere nese propozohet paraqet edhe demtimin e fondeve publike.

-Lidhur me pretendimin tjeter per marreveshjen per bazen e ebetonit ju sqaroj se nuk eshte kerkuar ndonje marreveshje me pika specifike e as percaktimin e loteve, por eshte pranuar pasi qe ka ekzistuar si marreveshje dhe ka licence per kete veprimtari.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit